



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË , KOSOVO POLJE**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Str.	180
Date/Data	20.02.2019
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE Fushë Kosovë	

DREJTORIA PËR ARSIM
Fushë Kosovë

Ministria e Arsimit , Shkencës dhe Teknologjisë në kuadër të grantit specifik në Komuna për vitin 2019 , ka përfshi një politikë të re , punësimin e Asistentëve për fëmijët me nevoja të vecanta arsimore .

Mbështetur në nenin 8 të Ligjit të Punës , neni 35 paragrafi 1,4,5 dhe 8 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032 , neni 5 pika c , të Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikës së Kosovës dhe nenit 7 pika 4 të UA të MASHT-it nr.10/2018 Normativi për Kuadrin e Arsimit të Përgjithshëm , Drejtoria e Arsimit në Fushë Kosovë shpallë :

K O N K U R S

për 4 (katër) Asistentë për fëmijë me nevoja të vecanta arsimore

Kualifikimi i nevojshëm : shkolla e mesme dhe niveli 5 –të (postsekondar) Pearson asistent për fëmijë / nxënës me nevoja të vecanta arsimore .

Paga bazë : 397.01 Euro .

Detyrat dhe roli i asistentes / it për fëmijë me nevoja të vecanta :

- Ndhmon fëmijët /nxënësit zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë , orientim dhe mobilitet, transport , pozitën dhe uljen e nxënësit në klasë
- Punon me mësimdhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-së , lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve
- Përgatitë materiale mësimore si dhe menaxhon me paisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës
- Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë e identifikuar të fëmijëve , përgatitë informata kthyesë për vështirësitë dhe arritjet e fëmijëve
- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim , pjesëmarrje në lojë dhe stimulimin e të folurit dhe gjuhës përmes bisedës dhe lojës

- Mbikqyrë dhe ndihmon fëmijët gjatë racioneve ushqimore , kujdeset për nevojat fizike-personale , mjekësore dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përfgjithshme të tyre
- Planifikon me mësuesin -it programin ditor dhe javor për mësim, aktivitete dhe ngjarje me qëllim të mbështetjes së fëmijëve për mësim
- Promovon bashkëpunimin shkollë-shtëpi , mbështet dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/ kujdestarin
- Respekton rregulla dhe etikën e shkollës, sjelljet e mira ndaj nxënësve
- Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve
- Informacionet në shkollë i trajton si plotësisht konfidenciale

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

- Diplomën ose Certifikatën e diplomës së kualifikimit të nivelit të pestë (5) PEARSON , kopje e vertetuar
 - Certifikatën e lindjes
 - Kopje e letërnjoftimit
 - Certifikata se nuk është nën hetime
- Dokumentet nuk kthehen.

Afati i kontratës së punës zgjatë nga data e fillimit të punës deri më 31.08.2019, me mundësi vazhdimi .

SQARIM : Të drejtë aplikimi kanë vetëm kandidatët me përgatitje profesionale përkatëse të diplomuar në nivelin e pestë (5) PEARSON .

Konkursi mbetet i hapur 10 ditë nga dita e publikimit në web faqen zyrtare të Komunës së Fushë Kosovës .

Aplikacionet dorëzohen në Arkiv të Komunës së Fushë Kosovës , rruga e Pejës p.n , 12000 Fushë Kosovë .

DREJTORI I DKA

Fushë Kosovë

